



29/06/2022

Tiranë – Sekuestrohen një armë zjarri dhe një sasi municioni luftarak, shpallet në kërkim 25-vjeçari që i kishte fshehur në çatinë e banesës së tij

Vijon bashkëpunimi me qytetarët, për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë.

Falë këtij bashkëpunimi, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6 goditën një rast të armëmbajtjes pa leje.

Sekuestrohen një armë zjarri dhe një sasi municioni luftarak, shpallet në kërkim 25-vjeçari që i kishte fshehur në çatinë e banesës së tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Nr. 6, në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar në informacionet e siguruara falë bashkëpunimit me qytetarët, se në rrugën “Hamdi Cenoimeri”, një shtetas mbante armë zjarri në banesë, menjëherë kanë organizuar punën dhe kanë ushtruar kontroll të befasishtëm në banesën e tij.

Gjatë kontrollit të ushtruar në këtë banesë, në pjesën e çatisë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri kallashnikov, dy krehra dhe një sasi municioni luftarak.

Në vijim të veprimeve u shpall në kërkim shtetasi H. A., 25 vjeç, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë falënderon qytetarët, për bashkëpunimin, dhe i fton që të vazhdojnë të denoncojnë në numrin 112 dhe në Komisariatin Dixhital, çdo rast paligjshmërie që ata evdientojnë.

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Qarku Korçë – Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohen penalisht në gjendje të lirë 2 të tjerë, për vepra të ndryshme penale


Raporti ditor i ngjarjeve, Policia e Shtetit, 29 qershor 2022 ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)